

LABINOT KRASNIQI

ERIC HAMP PËR ZHVILLIMET E LARINGALEVE I.E. NË

GJUHËN SHQIPE

811.18:811.1/2

811.1/2:811.18

Laringal është një tingull që formohet në larings, ta themi shqip, në skërfyell (Çabej, 1986: 77). Në temën për laringalet që trajton Çabej në veprën e tij, Studime Gjuhësore VII, mësojmë se Ferdinand de Saussure (1878), nga përfaqësuesit më të mëdhenj të gjuhësisë indoeuropiane dhe të përgjithshme moderne, kishte shtruar tezën që zanoret e gjata të gjuhëve indoевropiane, ā, ē, ō, në një kohë prehistorike, shumë të lashtë, para dokumentimit të gjuhëve më të vjetra si greqishtja, indishtja e hetitishtja, janë përfshuar nga një zanore përkatëse e shkurtër plus një *y. Kështu, sipas tij ë (e gjatë) ka dalë nga një e (e shkurtër) + *y ose ë < e+*y, gjithashtu ō (e gjatë) nga një o (e shkurtër) + *y (*o + *y > ō) po kështu edhe ā < a + *y. Saussure i quajti ato *koeficientë sonantikë*. Kjo tezë u pranua nga disa dijetarë, po nuk pati shumë efekte në atë kohë. Ndodh që të shtrohet një tezë, e cila as nuk miratohet, as nuk hidhet poshtë. Pra, u mendua për një element vokalik, i cili duke iu shtuar zanoreve të shkurtra përftoi këto të gjatat. Kjo është teza e De Saussurit. Linguisti danez *Hermann Möller*, duke krahasuar gjuhët indoevropiane me gjuhët semite, edhe ai kishte ardhur në një përfundim të afërt me atë të De Saussurit. Kur u zbulua pastaj hetitishtja u pa se greqishtes *pŷr* “zjam”, anglishtes *fire*, gjermanishtes *Feuer*, hetitishtja i përgjigjej me një *fjalërahħur* që përbante një *ħ*. Ndërsa në greqishtë kishte një ū (të gjatë) në hetitishtë kishte pranë a dy *ħħ*, një *ħ* dyfishe. Kjo pati pasojat e veta. Atëherë u rimor githë kjo teori e De Saussurit. I mbeti Jerzy Kuryłowicz-it (1935)të propozojë se këta tinguj kanë lidhje me supozimet e De Saussur-it. Sipas tij, konsonantet e panjohura të hetitishtes ishin në fakt një refleks i drejtpërdrejt i koeficientëve sonantikë të Saussur-it. Kjo shpjegoi gjithashtu shumë gjëra tjera; shpjegoi p.sh. se pse rrënjet e foljeve të përbëra vetëm nga një bashkëtingëllore dhe një zanore, kanë çdoherë zanore të gjatë: shq. rrī, angl. dō etj.

Pastaj u shtruan pyetje të ndryshme, se a kanë ekzistuar këto laringale apo jo, nëse kanë ekzistuar, sa laringale ka pasur, a kanë qenë vokalike apo konsonantike? Saussuri mendoi që ky element, të cilin ai e shënoi me një *y, është diçka si një gjysmëvokal, si një ī, domethënë diçka mes vokaleve dhe konsonanteve dhe mendoi që gjuha mëmë ka pasur dy deri dhjetë laringale. Sot më shumë mendohet që këto laringale, në qoftë se kanë ekzistuar, kanë qenë tri dhe i shënojmë me H_1 , H_2 , H_3 .

Çabej jep vetëm një sqarim për teorinë e laringaleve, duke dhënë edhe pak literaturë se kush është marrë me këtë studim. Çabej gjithashtu shpreh mosbindjen e plotë të tij për ekzistimin e këtyre laringaleve (“...në qoftë se kanë ekzistuar...”). Dëshmi për ekzistimin e laringaleve në shqipe Çabej nuk ofron.

Për laringalet janë marrë studiues të ndryshëm për gjuhët e ndryshme indoevropiane. Por për zhvillimin e tyre në shqipe, është një numër i kufizuar i gjuhëtarëve që kanë studiuar këtë fushë. Në veçanti janë studiesit amerikanë që kanë hedhur hapat e parë në trajtimin e kësaj çështjeje në shqipe. Robert Minshall në një artikull të shkurtër të vitit 1956 jep një sqarim shkurtimthi rrëth “Initial voiced laryngeal plus */y/ in Albanian”. Punimin më të plotë në këtë fushë pas tij e ka bërë Eric Hamp, veçanërisht në “Evidence in Albanian, Evidence for Laryngeals” (1965), i cili artikull tashmë është përkthyer edhe në gjuhën shqipe

dhe është botuar nga ASHAK-u së bashku me disa punime të tjera të Hamp-it, në vitin 2007, në librin “Studime krahasuese për shqipen”.

Kohëve të fundit me studimin e laringaleve më detajisht është marrë edhe një albanolog shqiptar, Bardhyll Demiraj. Demiraj në vitin 1998 ka publikuar një artikull për zhvillimet e laringaleve nistore ie. në shqipe, ku trajton raste të reflekseve të laringaleve në shqipe. Ndërsa artikulli i fundit, i botuar më 2015, që ka si rast studimi teorinë e laringaleve ie. dhe zbatimin e saj, konsiderohet si punimi më i plotë i Demirajt në këtë fushë.

Demiraj është munduar të përcjellë jehonën dhe zhvillimet që përjeton prej kohësh kjo teori në gjuhësinë historike-krahasuese indoeuropiane, e cila ka zënë vend tashmë përfundimisht në ligjet shkencore e universitare të indoeuropeanistikës, dhe cilëson se emërtimi “teori” vazhdon të përdoret vetëm për hir të traditës mësenjëshekullore të studimit. (Demiraj, 2015)

Demiraj në punimin e tij për laringalet trajton tiparet fonologjike dhe nyjëtimore të fonemave laringaleve dhe pastaj sjell dëshmi të zhvillimit të këtyre laringaleve në shqipe.

Sa i përket tipareve nyjëtimore të fonemave laringale ie. nuk zoteron ende një mendim i përgjithshëm, andaj në literaturën indoeuropeanistike bashkëkohore ato vijojnë të përcillen ende kryesish me simbolin aljebrik h, më rrallë edhe me simbolin Schwa indogermanicum*^ə (Demiraj, 2015)

Gjurmë të laringaleve ie. me funksion bashkëtingëllor identifikohen vetëm në grupin anatolik (p.sh. hetitishtja që dëshmon një bashkëtingëllore fërkimore h) (Demiraj, 1998), e sipas Hamp-it kemi edhe në shqipe në disa fjalë që nisin me spirantin h- (p.sh. *herdhe*). Hamp e sheh pasardhësen e njërsë prej laringaleve të humbura ie. te h- e shqipes, e cila është ruajtur deri në ditët e sotme.

Hamp sjell dëshmi të ndryshme të laringaleve në shqipe, “duke cituar forma...nga dialekti kalabrez i shqipes i Vakaricës arbëreshe (krah. e Kozencës) dhe nga dialekti i shqipes në Greqi i Sofikës (Korint)”, ndërsa format librore i pranon vetëm ato të cilat i beson si të sigurta.

Sipas Hamp-it, në shqipe gjenden gjurmë të laringaleve nistore indoevroniane vetëm kur ato ndodhen në pozicion parazanor. Edhe dëshmitë i ka sjellë sipas kësaj. Në të kundërt të tij, Demiraj ka sjellë gjurmë të tyre edhe në pozicione të tjera.

Gjatë diskutimit, Hamp parapëlqen të ndiqen simbolet e Lehmann-it për laringalet e veçanta, i cili duke ndjekur *Sapir-in*, supozon katër laringale: /χ, γ, h, ?/.

Për dallim prej Hamp-it, Demiraj pranon vetëm tri laringale ie., për të cilat përdor simbolin h (përkatësisht */h₁, h₂, h₃/).

Demiraj më shumë mendon se këto laringale kanë pasur karakter bashkëtingëllor dhe supozon këto veçori fonetike:

*/h₁≈[ç] (laringale palatale: më e prapme se arb. Gr. /ç/, khs. [çé] “híe”), [h] ose [?] (tinguj kërcitës: 'Alif').

*/h₂≈ [χ] (laringale uvulare: më e prapme se arb. Gr./x/, khs.: *xar* “hare”) ose [ħ] (spirante faringale e pazëshme).

*/h₃≈ [β]/[βʷ] (laringale uvulare e zëshme (jo)buzore, deri diku e ngjashme me (por më e prapme se) arb. Gr. /ɣ/, khs. *ɣajður*“gomar”), ose [?] (*Ajn – në arabishte*).

Laringalet h₂, h₃ janë laringalet me ngjyrim vokalik drejt zanoreve /a/, përkatësisht /o/. (Demiraj, 1988)

Hamp nuk jep veçori fonetike nyjëtimore për laringalet, megjithatë duke ndjekur Lehmann-in dhe Sturtervant-in propozon të përdoren këto simbole:

X~ç do laringale

H~ ç do laringale e pazëshme

E ~ laringale që ngjyros jo-a
 A ~ laringale që ngjyros a
 Q ~ laringale që ngjyros o
 H ~ laringale e ruajtur në hetitishte
 Z ~ laringale që nuk është ruajtur në hetitishte

Materiali gjuhësor, që saktësoi praninë e laringaleve në sistemin fonologjik të rindërtuar ie, u zbulua me deshifrimin dhe njohjen e hetitishtes si gjuhë ie. Në hetitishte ndodhet një bashkëtingëllore spirante /h/ [χ] – e pasqyruar grafikisht me shenjën kuneiforme /h/, e cila sipas Demirajt, vijon pandërmjetshëm të paktën njëren ndër fonemat laringale të rindërtuara për gjuhën bazë ie, përkatësisht h₂, khs.:
 ie. */h₂ent-i/: het. *hant-i* lok. “në anën e parme, përballë”, lat. *ante* “para”.
 ie. */h₂ertk'o-s/ pranë **/h₂rkpo-s/ “ari” het. *hartagga-* pranë ind. vj. *r'ksa-* shq. arietj.

Më lart kemi cekur se Hamp e sheh pasardhësen e ndonjërs laringale ie. te h- e shqipes. Në të mirë të këtij qëndrimi ai merr shembuj. Njëri nga shembujt që merr është edhe shembulli i cekur më lart për shq. *ari*. Ai dëshmon se ka forma (me gjasë dialektore) me h- në shqipen, “espacially for the female bear”: *harushë* pranë *arushë*; duke e krahasuar me formën e hetitishtes *hartaka-*. (Hamp, 2007)
 Së fundmi do të japim disa dëshmi për zhvillimet e laringaleve i.e. në shqipe kur ndodhen në pozicion nistor parazanor. Shpjegimet do të jenë sipas Hamp-it, duke i mbështetur edhe me shpjegimet e Bardhyl Demirajt.

Para zanoreve

Laringalja */h₁/ ose */?/ jep zero në shqipe sipas Demirajt dhe Hamp-it. Para */i/, */u/ mungojnë shembuj të sigurt, sipas Demirajt. Dëshmi:

- ie. */h₁esmi/: pshq. */emm(-)/ > shq. *jam* (tash. I nj.) (Demiraj & Hamp)
- ie. */h₁opi-ro-/: pshq. */apir-/ > shq. *(i) epér* (Demiraj & Hamp),
- Vakaricë /im/, shq. im (mashk.): hetitisht *amung* ‘mua’, het. hieroglifike *amu* ‘unë’, arm. Im ‘imi’, të cilat i lidh me *?em-, *?m- (Hamp)
- Shq, ndër ‘midis’: lat. inter, arm. ənderk ‘zorrë’ - *?nter (: *?éntr-). (Hamp)
- Laringalja ie. */h₂/-, */h₃/, që ngjyros /a/ dhe /o/ në protoshqipe jep */h/- (? – para ie. */e(i)/, */u/, */i/) dhe ø (para ie. */o/)
- shq. (t., g.) /h/-, (dial.) ø:
- ie. */h₂ejd^hos/: shq. *(h)éthe* f., khs. gr. αιθος “djegie” (Demiraj)
- ie. (du.) */h₃erg^hih₁/: pshq. */hardī/ > shq. *hérdhe* f.(sh.), lidhet etimologjikisht me gr. ορχεις (sh.) dhe arm. orjik (sh.) (Demiraj & Hamp)
- ie. */h₂id^h-/: shq. *(i) hidhët, (h)idhtë* (<*hidh-të*) mb., lidhet etimologjikisht me gr. ιθαρος “i çelët” (Demiraj & Hamp)
- ie. */h₂uto-/: shq. hut ndf. “kot; bosh”, khs. gr. αυτως “më kot”. (Demiraj & Hamp)
- → shq. ø: (sipas Demirajt dhe Hamp-it)
- ie. */Hos -/: shq. *ah* m., arm. *hac'i*, gj. l. vj. *asc* “lloj frashëri”, (Demiraj & Hamp)
- ie. */h₂o -/: shq. *(i) áthët, áthtë* (<*ath-të*) mb., khs. lat. *acidus* “id.”.
- Vakaricë /æ-/ ‘fryhet, ënjte’, sanskr. áñiti ‘merr frymë’, lat. *animus* ‘shpirt’ - *χán (X-), protoshqipe *án-y-i. (Hamp)
- Vakaricë /élp/, Sofiko /élp/, shq. elb, gr. αλψι - * χalb-y. (Hamp)

LITERATURA:

- MINSHALL, R.: Initial voiced laryngeal plus */y/ in Albanian, Language 32, 1956.
- ÇABEJ, E. 1986: Hyrje në studimin krahasimtar të gjuhëve indoевropiane, në Studime Gjuhësore VII, Prishtinë, 1986.
- HAMP, E.: Evidence in Albanian, Evidence for Laryngeals, London – Hague – Paris, 1965, 123-141
- HAMP, E.: Studime krahasuese për shqipen, Prishtinë, 2007.
- DEMIRAJ, B.: Zhvillime të laringaleve nistore ie. në shqipe, në Studime Filologjike, 1998.
- DEMIRAJ, B.: Zhvillime të laringaleve indoevropiane në gjuhën shqipe, në Studime Filologjike, 2009.
- DEMIRAJ, B.: Mbi ndryshimin e paradigmës në studimin diakronik të shqipes për nga perspektiva e indoeuropeanistikës – Teoria e Laingaleve ie. dhe zbatimi i saj si rast studimi, në Studime Albanistike, ASHAK, Prishtinë, 2015.